



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e
Infrastrukturës dhe Energjisë”

“MBI PËRPUTHSHMËRINË”
Tematik

Nr.	Emërtimi	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2-3
II	HYRJA	4-6
<i>a.</i>	Qëllimi dhe Objektivat	4-4
<i>b.</i>	Identifikimi i çështjes	4-4
<i>c.</i>	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	4-5
<i>d.</i>	Përgjegjësitë e audituesve	5-5
<i>e.</i>	Kriteret e vlerësimit	5-5
<i>f.</i>	Standardet e auditimit	6-6
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	6-13
	<i>Drejtimi 1: “Ecuria e detyrimeve shtetërore si dhe masat e marra për arkëtimin e tyre, në shfrytëzimin e Burimeve Natyrore, fusha Hidroenergjetike”</i>	7-11
	<i>Drejtimi 2: “Shlyerja e detyrimeve të prapambetura që rrjedhin nga zbatimi i Vendimit të Arbitrazhit ndërkombëtar ICC në çështjen nr. 2029/MHN”</i>	12-13
IV	KONKLUZIONI I AUDITIMIT	13-16
V	ANEKSE	17-18



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

I- PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Një përshkrim i shkurtër i auditimit

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”, më poshtë ASH, për periudhën 01.01.2018 deri më 31.08.2019 me objekt “Auditim tematik përputhshmërie”, lidhur me dy drejtime kryesore të përcaktuara në programin e auditimit dhe konkretisht “*Ecuria e detyrimeve shtetërore si dhe masat e marra për arkëtimin e tyre, në shfrytëzimin e Burimeve Natyrore, fusha Hidroenergjetike*” si dhe “*Shlyerja e detyrimeve të prapambetura që rrjedhin nga zbatimi i Vendimit të Arbitrazhit ndërkombëtar ICC në çështjen nr. 2029/MHN*”. Në këtë auditim u angazhuan 3 (tre) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Konkluzionet përkatëse paraqiten në mënyrë më të hollësishme në pjesën e IV të këtij Raporti Përfundimtar dhe konsistojnë kryesisht në:

Mungojnë kontabilizimet e penalteteve të propozuara nga AKBN nëpërmjet raporteve të monitorimit duke krijuar pasoja financiare të konsiderueshme për buxhetin e shtetit. Për rastet e veçanta “të pretenduara” nga MIE me mangësi të evidentueshme qartë dhe të kthyer për rishikim, nuk paraqiten veprime aktive lidhur me mbikëqyrjen institucionale në rolin e organit epror, për plotësimin e mangësive dhe kontabilizimin e vlerave përkatëse. Institucioni nuk disponon akte të brendshëm rregullativë lidhur me detyrat sektoriale apo funksionale, çka ka krijuar një amull në kryerjen e tyre, çorientim me delegimet, duke prodhuar risk të lartë në përmbushjen e detyrës funksionale dhe objektivave institucionale.

Në përfundim të procedurës audituese, akt-konstatimit, Projekt Raportit të mbajtur, observacioneve të paraqitura, u rekomanduan masat përkatëse për përmirësimin e situatës.

I.b. Një përmbledhje e gjetjeve kryesore dhe rekomandimet përkatëse paraqitet sa më poshtë:

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDË SIA	REKOMANDIMI
1.	Nga auditimi rezultoi se, me vendimin nr. 504, datë 13.9.2017 Këshilli i Ministrave ka përcaktuar fushën e përgjegjësisë shtetërore për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila veç të tjerash ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare dhe në sektorin e industrisë. Formimi i Ministrisë së re u pasua nga ndryshime në strukturën organizative të saj, por ky ndryshim nuk rezultoi të jetë shoqëruar me akte të brendshëm rregullativë për përcaktimin e qartë dhe të drejtë të detyrave funksionale, çka ka krijuar, paqartësi në kryerjen e tyre dhe risk të lartë në përmbushjen e detyrës publike dhe objektivave institucionale. Nga auditimi rezultoi se, me vendimin nr. 504, datë 13.09.2017 Këshilli i Ministrave ka përcaktuar fushën e përgjegjësisë institucionale për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila veç të tjerash ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme	Drejtimi nr. 1 “ <i>Ecuria e detyrimeve shtetërore si dhe masat e marra për arkëtimin e tyre, në shfrytëzimin e Burimeve Natyrore, fusha Hidroenergjetike</i> ” <i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 7-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i>	E lartë	- Nga ana e MIE, të merren masat e nevojshme për hartimin e akteve të brendshëm rregullativë lidhur me detyrat sektoriale apo funksionale konform strukturës organizative.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

	<p>shtetërore, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare dhe në sektorin e industrisë. Formimi i Ministrisë së re u pasua nga ndryshime në strukturën organizative të saj, por ky ndryshim nuk rezultoi në jetë shoqëruar me akte të brendshëm rregullativë për përcaktimin e qartë dhe të drejtë të detyrave funksionale, çka ka sjellë, funksionim jo të plotë të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe risk të lartë operacional në përmbushjen e detyrës publike dhe objektivave institucionale.</p>			
2.	<p>Nga auditimi rezultoi se, thuajse në të gjitha rastet raportet e monitorimit tre mujor të përcjella në MIE nga AKBN, si institucion i ngarkuar për monitorimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë hidroenergjetike sipas kontratave të lidhura nga ministria e linjës mbeten pa veprim. Sipas të dhënave të MIE, raportet janë kthyer për rishikim nga AKBN, megjithëse në ta përfshihet një numër i konsiderueshëm kontratash të trajtuara dhe propozimesh të bëra për vendosje penalitesh lidhur me shkelje të kushteve të kontratës, por jo vetëm. Kthimi në bllok i raporteve të monitorimit pa veçuar rastet të cilat janë trajtuar korrekt nga AKBN ka sjellë si pasojë mungesën e aplikimit të penaliteteve në një vlerë të konsiderueshme. Gjithashtu, për rastet e pasaktësive “të pretenduara”, nuk evidentohen veprime të mëtejshme nga MIE në rolin e autoritetit qendror për mbikëqyrje, plotësimin dhe përmirësimin e tyre, çka tregon gjithashtu mangësi në përmbushjen e detyrimeve institucionale drejt organeve të varësisë. Për 8 (tetë) raste të monitoruara të hyra në MIE gjatë periudhës Janar 2017-Gusht 2019 për të cilat nuk disponohen aktet administrative për arkëtimin e tyre, vlera e munguar në kontabilitetin e MIE, shkon në rreth 2,025,281 mijë lekë.</p>	<p>Drejtimi nr. 1 “Ecuria e detyrimeve shtetërore si dhe masat e marra për arkëtimin e tyre, në shfrytëzimin e Burimeve Natyrore, fusha Hydroenergjetike”</p> <p>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 7-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</p>	E lartë	<p>- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), sipas propozimeve të rekomanduara nga AKBN të nxjerr aktet e nevojshme administrative për arkëtimin e vlerës së sanksioneve të cilat rezultojnë të pazbatuara prej rreth 2,025,281 mijë lekë, si dhe të informoj Kontrollin e Lartë të Shtetit për kontabilizimin e tyre.</p> <p>- MIE), të bëjë vlerësimin e duhur të situatës lidhur me parregullsitë e konstatuara, si dhe të marrë masa për sjelljen e procesit brenda “kornizës ligjore”. Mbi bazën e gjithë rekomandimeve të shprehura nga AKBN në vijimësi për secilën kontratë nëpërmjet raporteve tremujore të monitorimit apo shkresave të veçanta, të saktësojë penalitetet për moszbatim të kushteve të kontratës dhe të nxjerr aktet e nevojshme administrative për arkëtimin e vlerave përkatëse, një kopje e të cilave të dërgohet pranë AKBN^{së}.</p> <p>- MIE, në rolin e autoritetit kontraktor, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për hartimin e një databaze ndërvepruese me AKBN dhe plotësimin e saj me të gjitha sanksionet e vendosura sipas raporteve të monitorimit në nivel kontrate dhe HEC-i prej fillimit të veprave si dhe vlerat e arkëtuara prej tyre.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

II- HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”, më poshtë e emërtuar “MIE”, në bazë të programit të auditimit tematik të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr.623/2 prot. datë 06.09.2019, ndryshuar me nr.623/3 prot. datë 24.09.2019, i ndryshuar, për periudhën e auditimit nga data 01.01.2017 deri në 31.08.2019, me afat auditimi nga data 06.09.2019 deri më 03.10.2019, dhe lloj auditimi “Auditim Përputhshmërie” i cili u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K..... X..... (Përgjegjës grupi)
2. F..... Z.....
3. A..... K.....

Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i auditimit është, dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional, e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord, mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”. Vlerësimin e përputhshmërisë së veprimeve procedurale e administrative, të kryera me kriteret dhe kërkesat e legjislationit. Evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike, si dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes në vijim. Raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin apo lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

Objektivat e auditimit:

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”, gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi: Vlerësimi i saktësisë së informacioneve në aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator, nëse janë zbatuar parimet e profesionalizmit, të efikasitetit, dhe sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.

Identifikimi i çështjes:

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”, për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2017 deri më 31.08.2019, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni dhe konkretisht:

Auditimi u orjentua në kontabilizimin e detyrimeve si dhe masat e marra për arkëtimin e tyre, të evidentuara nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit të mbajtur, për AKBN gjatë vitit 2019, të cilat i janë përcjellë MIE-s nëpërmjet raporteve të monitorimit për fushën Hidroenergjetike.

Përgjegjësia e Drejtimit për Përputhshmërinë me legjislationin në fuqi:

Është detyrimi i menaxherëve të njëjësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

-Nëpunësi autorizues është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale .

-Nëpunës zbatues, i caktuar si është personi përgjegjës sipas kuadrit normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të treguesve financiarë.

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për auditimin e Përputhshmërisë

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar;

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4000*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (*INTOSAI*), bazuar në këto standarde në aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryejë në mënyrë efektive auditimin (*ISSAI 1300*)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (*ISSAI 1500/ISA 300*).

-Të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në *ISSAI*-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe *ISSAI* 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të vlerësuar përputhshmërinë e aktivitetit. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e evidencave të marra, akt-konstatimit dhe Projektraportit të mbajtur, observimeve të MIE lidhur me këto akte, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

Kriteret e vlerësimit:

-Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

-Ligji nr.9663, datë 18.12.2006 “Për Konkensionet”, i ndryshuar.

-Ligji nr.125/2013 “Për Konkensionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar.

-VKM nr. 547 datë 09.08.2006 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, i ndryshuar.

-VKM Nr. 822, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë leketrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar.

-Akte të tjera ligjore dhe nënligjore të detyrueshëm për zbatim.



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

Standardet e Auditimit

Auditimi u bazua në:

-Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren “Për Procedurat e Auditimit” miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 107 datë 08.09.2017, i ndryshuar, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si:

-Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë. Referencë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC.

Materialiteti dhe metodologjia e bazuar në risk

Kontrolli i Lartë i Shtetit konsideron një nivel sasior materialiteti deri në 2% në nivel grupi dhe llogarie. Në disa raste, gabimi edhe pse jo material nga ana sasiore, mund të shfaqet material nga *ana cilësore* “Një çështje ose grup çështjesh mund të jenë materiale ose për shkak të sasisë, natyrës (karakteristikave të brendshme) ose në varësi të kontekstit të tyre” për vet impaktin real por dhe ndjeshmërinë publike që ka veprimtaria e institucionit. Çështjet që janë materiale nga natyra ose përmbajtja duhet të zbulohen; ato do të lidhen me përputhësinë e veprimtarisë së institucionit, duke u përfshirë kështu në konkluzionet e auditimit. Megjithatë, mbetet në gjykimin e KLSH-së, që çështje të veçanta në varësi të rëndësisë dhe impaktit të tyre, të merren në konsideratë në raportin e auditimit.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar gjatë fazës së planifikimit;

-*Raporte dhe informacione* nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore.

-*Intervistimi i personelit* që ka patur role specifike.

Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara drejt anomalive materiale.

III- PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Me vendimin nr. 504, datë 13.9.2017 Këshilli i Ministrave ka përcaktuar fushën e përgjegjësisë shtetërore për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky institucion ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore, në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës dhe transportit, në sektorin e telekomunikacionit e shërbimit postar, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare dhe në sektorin e industrisë. Për fushën hidroenergjetike, objekt i këtij auditimi tematik kjo ministri me emërtim dhe fushë të përgjegjësisë shtetërore të ripërcaktuar, ka lidhur kontrata koncesionare dhe jokoncesionare për prodhimin e energjisë me shoqëri zhvilluese të veprave hidroenergjetike. Më tej këto kontrata nga MIE përcillen për monitorim drejt Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) AKBN, institucion varësie i krijuar sipas VKM nr.547 datë 09.08.2006 e cila veç të tjerash ka si objekt të punës së saj:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

- Mbikëqyr veprimtarinë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe *energjetike*;
 - *Monitoron kontratat koncesionare për hidrocentralet.*
 - Ndjek procesin e vlerësimit të investimeve të kryera për projektet e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike, në bashkëpunim me ekspertë vlerësues të pavarur, të caktuar nga ministri përgjegjës për sektorin e energjisë.
- Detyrat e këtij institucioni varësie përcaktohen në statut-rregulloren e miratuar po nga Ministri i linjës si autoritet qendror.

🚩 Drejtimi 1: “Ecurinë e detyrimeve shtetërore si dhe masat e marra për arkëtimin e tyre, në shfrytëzimin e Burimeve Natyrore, fusha Hidroenergjetike”

Në MIE thuhet në frekuenca tremujore mbërrijnë raportet 3-mujore përcjella nga AKBN dhe. Nga MIE për monitorim kryesisht përcillen dy kategori kontratash, ato koncesionare dhe jokoncesionare të cilët janë Hec-et deri nën 2MW parashikuar në VKM nr.822 datë 17.10.2015 ku Këshilli i Ministrave bazuar në pikën 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” ka vendosur miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni. Për dy kategoritë e mësipërme të kontratave gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit në MIE mbërrijnë raportet e monitorimit në frekuenca 3 mujore me rezultatet e monitorimeve në to për vendimmarrje të mëtejshme. Këto raporte së bashku me konkluzionet e nxjerra nga monitorimi AKBN i përcjell në zbatim të detyrave/përgjegjësisë të saj për përmbushjen e detyrimeve kontraktore nga ana e operatorëve. Në rastet e shkeljeve të dispozitave të këtyre kontratave AKBN propozon penalitetet përkatëse ndërsa si palë në kontratë të drejtën vendimmarrëse si Autoritet Kontraktor e ka MIE .

Për kontratat e lidhura gjatë kohës në të cilën ka qenë në fuqi Ligji nr.9663, datë 18.12.2006 “Për Konkensionet”, i ndryshuar se, "Autoritet kontraktues" është autoriteti publik, që ka përgjegjësinë të lidhë kontratë koncesioni, çdo është ministri apo njësi e qeverisjes vendore që, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, është përgjegjëse për veprimtarinë ekonomike, për të cilën jepet koncesioni, referuar nenit 5 të tij trajtohet.

Po kështu në të njëjtën mënyrë termi "Autoritet kontraktues" gjendet edhe në ligjin nr.125/2013 “Për Konkensionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar, ku "Autoritet kontraktues" janë organet, të cilave ky ligj u jep kompetencat për të ndërmarrë një procedure për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private të cilët janë:

a) ministrinë e linjës;

b) njësitë e qeverisjes vendore.

Në nenin 26 “Lidhja e kontratës” pika 5 e tij përcaktohet se, “Kontrata hartohet me shkrim dhe nënshkruhet nga personi i autorizuar i autoritetit kontraktues dhe ofertuesi i zgjedhur si më i suksesshmi”.

Për periudhën objekt auditimi pranë MIE kanë mbërritur raportet 3-mujore por nga kjo e fundit nuk rezulton kontabilizim penalitetesh për shoqëritë zhvilluese dhe më pas arkëtim i tyre sipas propozimeve të bëra nga AKBN. Theksojmë se, kontratat me shoqëritë zhvilluese parashikojnë që në rast aplikimi penalitetesh vlera përkatëse mbahet nga garancia për realizimit të kontratës e nëse kjo nuk mjafton, koncesionari duhet ta zëvendësojë atë rast pas rasti. Verifikimi i instrumentave të garancisë veç kontratës parshikohet edhe në dispozitat e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

ligjit nr.125/2013 “Për Konkensionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar, i cili në nenin 28 “Garancitë e realizimit të kontratës” përcakton se,

1. Para nënshkrimit ose hyrjes në fuqi të kontratës, autoriteti kontraktues merr nga ofertuesi më i suksesshëm garancitë e kërkuara për realizimin e kontratës dhe instrumentet e sigurisë si kompensim për dëmin që mund të shkaktohet si pasojë e dështimit të koncesionarëve/partnerëve privatë për të përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë....
2. Garancitë dhe instrumentet e sigurisë depozitohen pranë autoritetit kontraktues, i cili është i detyruar t'i ruajë ato gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kontratës.
3. Autoriteti kontraktues verifikon rregullisht vlefshmërinë e instrumenteve të sigurisë.

Në muajin Gusht 2019 KLSH ka përfunduar një auditim përputhshmërie për fushën Hidroenergjetike pranë AKBN njësisë varësie e MIE, ku janë evidentuar mungesa në dosjet e kontratave të akteve administrative për zbatimin e penaliteteve nga MIE sipas propozimeve në raportet e monitorimit.

Kështu vetëm në 10 HEC-e nga 14 të audituar gjithsej, të cilët kishin përfunduar procesin e ndërtimit dhe ishin lidhur me rrjetin energjetik, të cilët nga AKBN gjendeshin me shkelje të kushteve të kontratës ishin rekomanduar penalitetet si më poshtë.

Tabela nr.1

Nr.	Koncesionari	H/C	Njësia	Vlera e penalitetit
1	“L.....sh.p.k.	S.....	/000 lekë	62,794
2	“E... D..”	D.....	/000 lekë	317,305
3	“Hec K...” sh.p.k.	H.....	/000 lekë	198,524
4	“D.....” sh.p.k.	T.....	/000 lekë	139,367
5	“R.....” sh.p.k.	Ç.....	/000 lekë	231,218
6	“D.....” sh.p.k.	D.....	/000 lekë	859,635
7	“M.....”	L....	/000 lekë	200,544
8	“H.....” sh.p.k.	Q.....	/000 lekë	15,894
9	“D.....” sh.p.k.	Z.....	/000 lekë	Nuk ka llogaritje
10	“T.....” sh.p.k	G.....	/000 lekë	Nuk ka llogaritje
	Shuma			2,025,281

Burimi: Auditimi i KLSH pranë AKBN

Nga sa më sipër, grupi i auditimit kërkoi zyrtarisht nga MIE informacion dhe dokumentacion lidhur me kontabilizimin e detyrimeve të paraqitura në raportet e monitorimit për periudhën nën auditim, veçanërisht për HEC-et e sipërcituar vlera e penaliteteve të të cilëve arrin në rreth **2,025,281 mijë lekë**, nëse kjo vlerë është reflektuar në kontabilitet dhe nëse po, sa është vlera e arkëtuar sipas HEC-eve përkatës.

Sipas përgjigjes të dhënë nga subjekti i audituar me nr. 7835/4 prot. datë 30.09.2019 në përgjigje të akt-konstatimit datë 24.09.2019 trajtohet se,

Viti 2017

Raporti i monitorimit tremujori i parë viti 2017 i rikthyer në AKBN për rishikim.

Raporti i monitorimit tremujori i dytë viti 2017 nuk disponohet informacion cilës drejtori në Ministri i është adresuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

Raporti i monitorimit tremujori i tretë dhe i katërt viti 2017 i rikthyer në AKBN për rishikim.

Viti 2018

Raporti i monitorimit tremujori i parë dhe i dytë viti 2018 i rikthyer në AKBN për rishikim.

Raporti i monitorimit tremujori i tretë dhe i katërt viti 2018 në proces shqyrtimi.

Në përgjigjen e subjektit të audituar evidentohet se, raportet e sipërcituar janë rikthyer në AKBN me qëllim rivlerësimin e konkluzioneve dhe llogaritjen e argumentuar të penalitetit përkatës si dhe trajtohet korrrespondenca shkresore midis AKBN, Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Drejtorisë së Programit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator lidhur me zbatimin e dispozitave të ndryshuara lidhur me monitorimin e prodhimit të energjisë elektrike penalitetet referuar Udhëzimit nr. 10496 datë 31.07.2018 dalë në zbatim të VKM nr. 332 datë 06.06.2018 “Për disa shtesa në VKM nr.547 datë 09.08.2006” letërkëmbim të cilat datojnë në periudhën shkurt-korrik 2019 por njësia përkatëse në MIE, “Drejtoria e Programit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator” nuk kanë sqaruar ende në mënyrë shteruese kërkesën për interpretim.

-Lidhur sa më sipër evidentohet se, vetëm në disa raste kontratat e monitoruara kanë propozime për penalitete lidhur mos realizimin e prodhimit të energjisë elektrike dhe aq më pak në HEC-et të cilët sapo kanë përfunduar procesin e ndërtimit siç është rasti i HEC-eve të përmendur më sipër. Pretendimet e MIE për kthimin e raporteve lidhur me këtë çështje nuk qëndrojnë edhe për faktin se raportet e monitorimit vijnë ndërkohë që vet MIE si “Autoritet Kontraktues” dhe vendimmarrës për kontratën, nuk ka sqaruar hollësisht procedurën për tu ndjekur apo të jetë shprehur ndryshe.

Sa i përket pretendimeve të subjektit të audituar lidhur me vlerën e trajtuar edhe pranë AKBN i cili është institucion në varësinë e saj të drejtpërdrejtë sqarojmë se, KLSH ka dërguar raportin e plotë të auditimit pranë MIE dhe ka bërë rekomandimet përkatëse për këtë vlerë të evdientuar po nga raportet e monitorimit e cila duhet të kontabilizohet nga kjo e fundit. Sa më sipër ky pretendim i MIE nuk qëndron.

Evidentohet se, krijimi i Ministrisë së re u pasua nga ndryshime në strukturën organizative të saj por ky ndryshim nuk rezulton të jetë shoqëruar me akte të brendshëm rregullativë lidhur me detyrat sektoriale apo funksionale, çka ka krijuar një amulli në kryerjen e tyre, çorientim me delegimet duke prodhuar risk të lartë në përmbushjen e detyrës publike dhe objektivave institucionale.

Sa më lartë, vlera prej **2,025,281 mijë lekë** nuk rezulton e kontabilizuar në regjistrat e MIE e rrjedhimisht përbën një vlerë të munguar në buxhetin e shtetit.

Me shkresën nr. 783/6 prot. datë 17.10.2019, MIE ka paraqitur observacion për Projektraportin ku ndër të tjerat citohet se,

-.....Rezulton se për periudhën audituese, nga ana e MIE raportet e sipërcituar të monitorimit janë rithyer në AKBN, me qëllim rivlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga monitorimi i hdirocentraleve të paraqitura në raportet e dërguara prej saj dhe në çdo rast llogaritjen e argumentuar të penalitetit përkatës për shkelje të detyrimeve nga na e shoqërive , mbi bazën e të cilave AK do të gjykoj më tej mbi përmbushjen e detyrimeve të kontratës nga koncesionari dhe aplikimin e sanksioneve që parashikohen në rast mosrealizimi , pasi siç edhe vet AKBN është shprehur, ka paqartësi në përlllogaritjen e penaliteteve.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

...bëjmë me dije se në kuptimin tonë , sa i përket fushës së hidroenergjisë detyrim shtetëror përbëjnë ato detyrime të parashikura në kontratat koncesionare (nënkuptoni fee-në koncesionare) dhe ato propozime të AKBN për penalitete të cilat më pas janë gjykuar të drejta dhe aplikuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, duke u bërë titull ekzekutiv , dhe vetëm në këtë rast mos-kontabilizimi i penaliteteve të aplikuara ndaj shoqërive koncesionare apo mbajtësve të miratimit përfundimtar duhet të quhen/konsiderohen dhe llogariten si të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

...mbështetur në informacionin e dhënë nga ana jonë mbi vijimin e trajtimit që MIE i ka bërë raporteve periodike 3-mujore të AKBN, del qartë së propozimet e AKBN nuk janë finalizuar me aplikim penalitetesh për shkaqet e përmendura më sipër dhe hollësisht përshkruar në shkresat përkatëse që MIE ka bërë për AKBN, (propozime të paqarta , jo të argumentuara) dhe në këtë kuptim meqënëse nga na e MIE nuk është vijuar me aplikimin e penalitetesh do të thotë se këto nuk janë detyrime shtetërore dhe për më tepër nuk mund të quhen detyrime të munguara në buxhetin e shtetit dhe në këtë kontekst nuk mund të flasim për kontabilizim vlere.

Qëndrimi i audituesve shtetërorë të KLSH^{-së}

Sa trajtohet nga ana juaj lidhur në paragrafin e parë ri-sqarojmë se, jo në të gjitha rastet penalitetet burojnë nga penalitetet për mosrealizim energjie. Në këtë auditim ne kemi trajtuar vetëm një pjesë të HEC-eve, ata të cilët kishin përfunduar ndërtimin gjatë periudhës së auditimit, ndërkohë numri i subjekteve dhe vlerat e propozuara janë disa fish më të larta nga ajo çka po auditohet nga ana jonë. Paqartësia lidhur me mënyrën e llogaritjes për energjinë, pretenduar nga ana juaj ka gjetur trajtim të veçantë në Raportin Përfundimtar të Auditimit mbjatur nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për AKBN, konkretisht *Drejtimi 4: “Shlyerja e detyrimeve ndaj shtetit gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit të prodhimit të energjisë*, një kopje të të cilit KLSH e ka përcjellë pranë MIE, në rolin e organit qendror dhe njëkohësisht Autoritet Kontraktues. Në të janë përcaktuar qartë problematikat e evidentuara edhe rekomandimet përkatëse për tu zbatuar nga MIE. Në të gjitha aktet ligjore si VKM nr. 332, udhëzimi në zbatim të tij apo dhe akte të mëparshme është vet MIE institucioni që i ka propozuar këto akte apo miratuar ato si në rastin e udhëzimeve dhe në kushtet edhe të qenit organ qendror duhet ti kishte sqaruar ato në mënyrë shteruese pas çdo kërkesë për interpretim, dhe jo të thëllonte më tej paqartësitë.

-Lidhur me paragrafin e dytë dhe të tretë më sipër sqarojmë se, ju së pari ju pranoni mungesën e kontabilizimit për të gjitha rastet. Për termin të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit biem dakord me përcaktimin që penalitetet rregullisht duhet të kontabilizoheshin dhe më pas të vilesnin nga institucioni, por në rastin tonë ky kontabilizim mungon megjithëse penalitetet janë evidentuar e si i tillë nëse njësia publike nuk kryen veprimet e duhura për kontabilizimin e tyre si mund të quhet ndryshe?

Sa trajtuar më sipër por dhe në materialin e auditimit, observacioni nuk merret në konsideratë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

Titulli i Gjetjes 1	Mungesë e kontabilizimit të penaliteteve me efekte financiare të konsiderueshme
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, thajse në të gjitha rastet raportet e monitorimit tre mujor të përcjella në MIE nga AKBN, si institucion i ngarkuar për montorimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë hidroenergjetike dhe kontratave, mbeten pa veprim. Sipas të dhënave të MIE, raportet janë rikthyer për rishikim nga AKBN, megjithëse në ta përfshihet një numër i konsiderueshëm kontratash të trajtuara dhe propozimesh të bëra për vendosje penalitesh lidhur me shkelje të kushteve të kontratës, por jo vetëm. Kthimi në bllok i raporteve të monitorimit pa veçuar rastet të cilat janë trajtuar korrekt nga AKBN ka sjellë si pasojë mungesën e aplikimit të penaliteteve në një vlerë të konsiderueshme. Gjithashtu, për rastet e pasaktësive “të pretenduara”, nuk evidentohen veprime të mëtejshme nga MIE në rolin e autoritetit qendror për mbikëqyrje, plotësimin dhe përmirësimin e tyre, çka tregon gjithashtu mangësi në përmbushjen e detyrimeve institucionale drejt organeve të varësisë. Për 8 (tetë) raste të monitoruara të hyra në MIE gjatë periudhës Janar 2017-Gusht 2019 nuk disponohen aktet administrative për arkëtimin e tyre
Kriteri :	Ligjin nr.125/2013 “Për Konkensionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar, neni 13, neni 26 pika 5. Dispozitat e kontratës dypalëshe të lidhur nga Autoriteti Kontraktues.
Ndikimi/Efekti	Vlera e munguar në kontabilitetin e MIE, shkon në rreth 2,025,281 mijë lekë.
Shkaku:	Mungesë e veprimeve nga hallkat përgjegjëse për kontabilizimin e penaliteteve.
Rëndësia	E Lartë

Titulli i Gjetjes 2	Mungojnë aktet rregullative për proceset e punës sipas strukturës së re organizative
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, me vendimin nr. 504, datë 13.9.2017 Këshilli i Ministrave ka përcaktuar fushën e përgjegjësisë shtetërore për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila veç të tjerash ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare dhe në sektorin e industrisë. Formimi i Ministrisë së re u pasua nga ndryshime në strukturën organizative të saj, por ky ndryshim nuk rezultoi në jetë shoqëruar me akte të brendshëm rregullativë për përcaktimin e qartë dhe të drejtë të detyrave funksionale.
Kriteri :	Ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 29. Ligji nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 8.
Ndikimi/Efekti	Paqartësi në kryerjen e detyrave funksionale që shoqërohet nga risk i lartë në përmbushjen e objektivave institucionale.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga hallkat përgjegjëse.
Rëndësia	E Lartë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

Drejtimi 2: “Shlyerja e detyrimeve të prapambetura që rrjedhin nga zbatimi i Vendimit të Arbitrazhit ndërkombëtar ICC në çështjen nr. 2029/MHN”

-Verifikimi i ankesës nr.687, datë 19.09.2019 të shoqërisë V....., hyrë në KLSH me nr. 706, datë 20.09.2019.

Subjekti “V.....” ka paraqitur ankesë pranë KLSH, regjistruar me nr. 706 prot. datë 20.09.2019. .

Ankesa e shoqërisë ka të bëjë me mos shlyerjen nga MIE të detyrimeve të prapambetura që rrjedhin nga zbatimi i Vendimit të Formës së Prerë, të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit” çështja nr. 21,069/MHM, datë 29.11.2016 e cila ka vendosur që ish MTI (sot MIE), t’i paguajë shoqërisë shumat si vijon:

a. 396. 077 Euro plus interesin mbi këtë shumë në normën 3% mbi normën huadhënsë të Bankës së Shqipërisë, e krijuar çdo muaj nga data 22 dhjetor 2015 deri në datën e kryerjes së plotë të pagesës efektive;

b. 229 Paud Britanik, plus interesin në këtë shumën 3% mbi normën huadhënsë të Bankës së Shqipërisë, e krijuar çdo muaj nga data 22 dhjetor 2015 deri në datën e kryerjes së plotë të pagesës efektive;

c. 65 000 USD, paguajnë paraprakisht për Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit ICC. (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë dhe V.... shpk ndajnë në mënyrë të barabartë kostot totale të këtij arbitrazhi, në shumën 130 000 dollarë amerikan. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë urdhërohet t’i paguajë V..... shpk shumën 65.000 USD, paguajnë paraprakisht për Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit ICC (është paguar).

d. 47,509 lekë dhe

e. 1,788,9 euro taksat dhe sigurimet shoqërore etj. që Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë dhe V..... shpk ndajnë në mënyrë të barabartë kostot e vendit të seancës dëgjimor etj.

Në zbatim të këtij vendimi ka dalë urdhri i Ministrit të MIE nr. 326, datë 18.12.2017.

Me shkresë të Përmbauesit Gjyqësor nr. 1,122/15 prot. Datë 3.12.2018 është njoftuar MIE se ... Sipas Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka bërë njohjen e Vendimit të Formës së Prerë, të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit...” të çështjes nr. 21,069/MHM, datë 29.11.2016, është bërë rillogaritja e interesave mbi detyrimin nga data 22.12.2015 deri datë 10.11.2015”.

Sipas kësaj shkrese ... detyrimi **aktual** i MIE ndaj kreditorit “V.....” sh.p.k. përfshirë tarifën përmbaimore është 1,084,060 euro, 655 GBP dhe 7,336,032 lekë.

MIE me shkresë nr. 14,534/3, datë 11.12.2018 ka paditur subjektin “V.....” sh.p.k. dhe Përmbauesit Gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Objekti i padisë është “Kundërshtimi i veprimeve të përmbauesit gjyqësor privat”.

Sipas akt-ekspertimit kontabël datë 25.6.2019 të Auditueses Ligjore, caktuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, MIE ka shlyer detyrimet në përputhje me Vendimin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

e Formës së Prerë, të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit...” të çështjes nr. 21,069/MHM, datë 29.11.2016.

Aktualisht çështja është ndodhet në proces shqyrtimi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

-Lidhur me këtë pikë, duke qenë se çështja aktualisht ndodhet në proces shqyrtimi gjyqësor, grupi i auditimit nuk mund të dalë me konkluzion.

IV- KONKLUZIONE

Nga auditimi i kryer pranë “Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë” lidhur me, ecurinë e detyrimeve dhe masat e marra për arkëtimin e tyre rezultoi se:

-Veprimtaria e MIE lidhur me raportet e monitorimit të verpave hidrenergjetike paraqet mangësi të theksuara në organizimin dhe funksionimin e institucionit për këtë drejtim ku do të veçonim, moskontabilizimin e detyrimeve të propozuara në raportet e monitorimit, aspektin mbikqyrës ndaj veprimeve të paplota të AKBN për rastet e veçanta me mangësi të evidentueshme qartë, vonesat e tejzgjatura në interpretimin e dispozitave të propozuara nga vet kjo ministri etj. Këto mangësi kanë ndikuar negativisht në përmbushjen e objektivave institucionale duke u shoqëruar me pasoja financiare të konsiderueshme për buxhetin e shtetit ku vetëm për rastet e lartëpërmendur vlera shkon në rreth **2,025,281 mijë lekë**.

-Institucioni ende nuk disponon akte të brendshëm rregullativë lidhur me detyrat sektoriale apo funksionale, çka ka krijuar një amulli në kryerjen e tyre, çorientim me delegimet duke prodhuar risk të lartë në përmbushjen e detyrës publike dhe përmbushjen e objektivave institucionale.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si **më poshtë**:

A. MASA ORGANIZATIVE

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, me vendimin nr. 504, datë 13.09.2017 Këshilli i Ministrave ka përcaktuar fushën e përgjegjësisë institucionale për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila veç të tjerash ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare dhe në sektorin e industrisë. Formimi i Ministrisë së re u pasua nga ndryshime në strukturën organizative të saj, por ky ndryshim nuk rezultoi të jetë shoqëruar me akte të brendshëm rregullativë për përcaktimin e qartë dhe të drejtë të detyrave funksionale, çka ka sjellë, funksionim jo të plotë të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe risk të lartë operacional në përmbushjen e detyrës publike dhe objektivave institucionale. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 7-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandojmë: Nga ana e MIE, të merren masat e nevojshme për hartimin e akteve të brendshëm rregullativë lidhur me detyrat sektoriale apo funksionale konform strukturës organizative.

Brenda datës 31.12.2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, thuajse në të gjitha rastet raportet e monitorimit tre mujor të përcjella në MIE nga AKBN, si institucion i ngarkuar për monitorimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë hidroenergjetike sipas kontratave të lidhura nga ministria e linjës mbeten pa veprim. Sipas të dhënave të MIE, raportet janë kthyer për rishikim nga AKBN, megjithëse në ta përfshihet një numër i konsiderueshëm kontratash të trajtuara dhe propozimesh të bëra për vendosje penalitesh lidhur me shkelje të kushteve të kontratës, por jo vetëm. Kthimi në bllok i raporteve të monitorimit pa veçuar rastet të cilat janë trajtuar korrekt nga AKBN ka sjellë si pasojë mungesën e aplikimit të penalteteve në një vlerë të konsiderueshme. Gjithashtu, për rastet e pasaktësive “të pretenduara”, nuk evidentohen veprime të mëtijshme nga MIE në rolin e autoritetit qendror për mbikëqyrje, plotësimin dhe përmirësimin e tyre, çka tregon gjithashtu mangësi në përmbushjen e detyrimeve institucionale drejt organeve të varësisë. Për 8 (tetë) raste të monitoruara të hyra në MIE gjatë periudhës Janar 2017-Gusht 2019 për të cilat nuk disponohen aktet administrative për arkëtimin e tyre, vlera e munguar në kontabilitetin e MIE, shkon në rreth **2,025,281 mijë lekë**. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 7-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Ri-Rekomandojmë: MIE, sipas propozimeve të rekomanduara nga AKBN të nxjerr aktet e nevojshme administrative për arkëtimin e vlerës së sanksioneve të cilat rezultojnë të pazbatuara prej rreth **2,025,281 mijë lekë**, si dhe të informoj Kontrollin e Lartë të Shtetit për kontabilizimin e tyre.

Menjëherë

1.2 Ri-Rekomandojmë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të bëjë vlerësimin e duhur të situatës lidhur me parregullsitë e konstatuara, si dhe të marrë masa për sjelljen e procesit brenda “*kornizës ligjore*”. Mbi bazën e gjithë rekomandimeve të shprehura nga AKBN në vijimësi për secilën kontratë nëpërmjet raporteve tremujore të monitorimit apo shkresave të veçanta, të saktësojë penaltetet për moszbatim të kushteve të kontratës dhe të nxjerr aktet e nevojshme administrative për arkëtimin e vlerave përkatëse, një kopje e të cilave të dërgohet pranë AKBN^{së}.

Brenda datës 31.12.2019

1.3 Ri-Rekomandojmë: MIE, në rolin e autoritetit kontraktor, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për hartimin e një databaze ndërvepruese me AKBN dhe plotësimin e saj me të gjitha sanksionet e vendosura sipas raporteve të monitorimit në nivel kontrate dhe HEC-i prej fillimit të veprave si dhe vlerat e arkëtuara prej tyre.

Brenda datës 31.12.2019

C. -Verifikimi i ankesës nr. 687, datë 19.09.2019 të shoqërisë V....., hyrë në KLSH me nr. 706, datë 20.09.2019 me objekt, “Shlyerja e detyrimeve të prapambetura që rrjedhin nga zbatimi i Vendimit të Arbitrazhit ndërkombëtar ICC në çështjen nr. 2029/MHN”.

1- Gjetje nga auditimi: Subjekti “V.....” ka paraqitur ankesë pranë KLSH, regjistruar me nr. 706 prot. datë 20.09.2019. .

Ankesa e shoqërisë ka të bëjë me mos shlyerjen nga MIE të detyrimeve të prapambetura që rrjedhin nga zbatimi i Vendimit të Formës së Prerë, të Gjykatës Ndërkombëtare të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

Arbitrazhit” çështja nr. 21,069/MHM, datë 29.11.2016 e cila ka vendosur që ish MTI (sot MIE), t’i paguajë shoqërisë shumat si vijon:

a. 396. 077 Euro plus interesin mbi këtë shumë në normën 3% mbi normën huadhënsë të Bankës së Shqipërisë, e krijuar çdo muaj nga data 22 dhjetor 2015 deri në datën e kryerjes së plotë të pagesës efektive;

b. 229 Paund Britanik, plus interesin në këtë shumën 3% mbi normën huadhënsë të Bankës së Shqipërisë, e krijuar çdo muaj nga data 22 dhjetor 2015 deri në datën e kryerjes së plotë të pagesës efektive;

c. 65 000 USD, paguajnë paraprakisht për Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit ICC. (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë dhe V..... shpk ndajnë në mënyrë të barabartë kostot totale të këtij arbitrazhi, në shumën 130 000 dollarë amerikan. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë urdhërohet t’i paguajë V..... shpk shumën 65.000 USD, paguajnë paraprakisht për Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit ICC (është paguar).

d. 47,509 lekë dhe

e. 1,788,9 euro taksat dhe sigurimet shoqërore etj, që Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë dhe V..... shpk ndajnë në mënyrë të barabartë kostot e vendit të seancës dëgjimore etj.

Në zbatim të këtij vendimi ka dalë urdhri i Ministrit të MIE nr. 326, datë 18.12.2017.

Me shkresë të Përmbauesit Gjyqësor nr. 1,122/15 prot. datë 3.12.2018 është njoftuar MIE se ... Sipas Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka bërë njohjen e Vendimit të Formës së Prerë, të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit...” të çështjes nr. 21,069/MHM, datë 29.11.2016, është bërë rillogaritja e interesave mbi detyrimin nga data 22.12.2015 deri datë 10.11.2015”.

Sipas kësaj shkrese ... detyrimi **aktual** i MIE ndaj kreditorit “V.....” sh.p.k. përfshirë tarifën përbarimore është 1,084,060 euro, 655 GBP dhe 7,336,032 lekë.

MIE me shkresë nr. 14,534/3, datë 11.12.2018 ka paditur subjektin “V.....” sh.p.k. dhe Përmbauesit Gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Objekti i padisë është “Kundërshtimi i veprimeve të përmbauesit gjyqësor privat”.

Sipas akt-ekspertimit kontabël datë 25.6.2019 të Auditueses Ligjore, caktuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, MIE ka shlyer detyrimet në përputhje me Vendimin e Formës së Prerë, të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit...” të çështjes nr. 21,069/MHM, datë 29.11.2016.

Aktualisht çështja është ndodhet në proces shqyrtimi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe palët janë në pritje të vendimit.

Trajtuar më hollësisht në faqet nr 12-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1 Rekomandojmë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të bashkëpunoj me Avokaturën e Shtetit për tu përgatitur dhe ndjekur me përgjegjshmëri të lartë këtë gjyq sipas kornizës ligjore në fuqi, me qëllim shmangien e kostove të tepërta në dëm të buxhetit të shtetit që mund të vijnë nëse vendimi jepet në favor të shoqërisë “V.....”.

Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

1.2 Rekomandojmë: Në përfundim të këtij procesi gjyqësor, në rast se, Vendimi i Gjykatës është në favor të shoqërisë “V.....”, MIE, të analizoj dhe vlerësoj me një grup pune të veçantë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për vonesat e shkaktuara të cilat kanë sjell rritje të mëtejshme të kostove të shtetit, nga mosekzekutimi në kohë i detyrimeve dhe për më tej, natyrisht të zbatoj vendimin e gjykatës, pasi në këtë rast moszbatimi i vendimit vetëm e rëndon detyrimin financiar.

Me hyrjen në fuqi të Vendimit të Gjykatës

V. ANEKSE

Aneksi I - “Qasja dhe metodologjia e auditimit”

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

ANEKSI I

QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Materialiteti

Përcaktimi i materialitetit sipas **sasisë** përfshin gjykimin mbi nivelin maksimal të pranueshëm të shmangies së përputhshmërisë me dispozitat ligjore, rregulloret. Ky materialiteti vlerësohet **deri në 2%** në nivel grupi dhe llogarie.

Një gabim/anomali është “material”, individualisht ose kur bashkohet me gabime/anomali të tjera, në qoftë se në mënyrë të arsyeshme mund të ndikojë në vendimet e marra nga drejtimi.

Në disa raste, gabimi edhe pse jo material nga ana sasiore, mund të shfaqet material për nga përmbajtja - duke ndikuar kështu në konkluzionet e auditimit. Çështjet që janë materiale nga natyra ose përmbajtja duhet të zbulohen; e megjithatë mbetet në gjykimin e KLSH-së, nëse për raste të veçanta këto parregullsi/gabime do të merren në konsideratë në raportin dhe opinionin e auditimit.

Përcaktimi i materialitetit nga **ana cilësore** “Një çështje ose grup çështjesh mund të jenë materiale ose për shkak të sasisë, natyrës (karakteristikave të brendshme) ose nëvarësi të kontekstit të tyre” të cilat do të lidhen me përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit vlerësohen materiale nga ana cilësore për vet impaktin real por dhe ndjeshmërinë publike të cilin ka veprimtaria e MIE.

Vlerësimi i riskut të auditimit

Të kuptuarit e strukturës së kontrollit të brendshëm të njësisë që auditohet, përcaktimi i drejtimeve kryesore të auditimit, Vlerësimin e përgjithshëm mbi ekzistencën dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm me qëllim përcaktimin e nivelit të përgjithshëm të riskut të njësisë që auditohet.

Fazat:

Njohja e aktivitetit të subjektit me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e riskut të brendshëm. Vlerësimi i sistemeve të Kontrollit të Brendshëm

Përcaktimi i Riskut të Zbulimit, është risku që audituesi nuk do të arrijë të zbulojë një shmangie, e cila nuk është korrigjuar nga vetë sistemet e kontrollit të brendshëm të subjektit.

KLSH aplikon Modelin e Sigurisë, që tregon se niveli i besueshmërisë rrjedh nga dy burime kryesore që janë: sistemet e kontrollit dhe testet thelbësore.

Si pikënisje shërben risku i brendshëm

Risku i brendshëm (jo i lartë = 0.6 dhe i lartë = 1.0)

Gjykohet dhe vlerësohet që në fazën e planifikimit dhe ushtrimit të auditimit të përputhshmërisë, se mund të kemi elementë materialë për vlerësimin e një risku të brendshëm, që lidhet me një nivel të mundshëm të shmangieve përse i takon përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Gjykohet se ka elementë të **riskut të brendshëm**, që lidhen me procesin e vendimmarrjes, organizimin dhe funksionimin, kuadrin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë”

rregullator mbi të cilin ushtrohet veprimtaria por dhe madhësisë së saj risku i brendshëm paraprakisht vlerësohet **Jo i Lartë**.

Risku i Kontrollit të brendshëm (I ulët = 0.15, I mesëm = 0.25, dhe I lartë = 1.0)

Bazuar në të dhënat paraprake kontrolli i brendshëm ekziston dhe ka të ngjarë të funksionojë në mënyrë efektive dhe të vazhdueshme gjatë periudhës nën auditim. Por bazuar në kompleksitetin e operacioneve të subjektit dhe natyrën e kompleksitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, risku që një anomali materiale mund të ndodhë dhe mund mos të parandalohet ose zbulohet dhe korrigohet në kohë nga sistemet e kontrollit të brendshëm paraprakisht vlerësohet në nivelin **I Mesëm**.

Risikut i zbulimit

Duke qenë se KLSH konsideron **Risikun e Auditimit** në masën **5%** duke konsideruar një siguri auditimi prej 95% , **Risku i zbulimit** i përcaktuar mbi modelin e sigurisë vlerësohet si vijon:

Nr.	Zonat e auditimit të marra në shqyrtim	Rrisku i brendshëm (IR) (0,6 deri ne 1)		Rrisku i kontrollit të brendshëm (CR) (0,15 - 0,25 - 1)			Risku i zbulimit (DR)		Niveli i besueshmerise (1-DR)	Niveli i testeve thelbësore për t'u kryer
		I Ulët	I Lartë	I Ulët	I Mesëm	I Lartë	DR = AR/ (IR x CR)	DR ne (%)	(1-DR) Ne perqindje	
1	<i>Ecuria e detyrimeve shtetërore si dhe masat e marra për arkëtimin e tyre, në shfrytëzimin e Burimeve Natyrore, fusha Hidroenergjetike</i>		0.90		0.30		0.18	18%	82%	I fokusuar

Bazuar në informacionin paraprak metodologjia e auditimit vlerësohet të bazohet në përzgjedhjen me bazë risku, duke marrë në konsideratë ato kontrole që janë përkatës për objektivat e auditimit, ku rëndësi i jepet edhe gjykimin profesional të audituesit nëse një kontroll i veçuar ose në kombinim me të tjerë, është i përshtatshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti si dhe dokumentacionin shoqërues dhe verifikimin e tyre. Konkretisht, mbi të dhënat e disponuara u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm; dhe
- teste të detajeve.